



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 63 Datë 14.07.2010

Për miratimin e “PLANIT BASHKIAK PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË”

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës, “Për miratimin e Planit Bashkiak për Efiçencën e Energjisë”, mbështetur në: Ligji nr. 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” neni nr. 32, gërma “k”, dhe ligji nr. 8399 dt. 09.09.1998 “Për buxhetin lokal”, në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

- I. Të miratojë “Planin Bashkiak për Efiçencën e Energjisë”, i cili do të financohet nga të ardhurat e Bashkisë, nga Grantet Konkurruese të Qeverisë si dhe nga Donatorë të ndryshëm.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projekteve në Infrastrukturë, Drejtoria e Financës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

GJERGJI PENDAVINJI